



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot. 316

Tiranë, më 04 Maj 2023

**Drejtuar:** Z. Ilirjan Celibashi  
Komisioner Qendror i Zgjedhjeve  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**Nga:** Znj. Erida Skëndaj  
Drejtoreshë Ekzekutive  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Lënda:** Përcjellje sinjalizimesh mbi keqinformimin dhe presionin e ushtruar ndaj disa qytetarëve në Bashkinë Elbasan, për leximin e votës nga të tretët, të ushtruar me sistemin e pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik

I nderuar Z. Celibashi,

Së fundmi, në vëmendjen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) ka ardhur një sinjalizim nga disa qytetarë të shqetësuar të Bashkisë Elbasan, mbi pilotimin e procesit të votimit dhe numërimit elektronik.

Sipas tyre, eksponentë të lartë të subjektit zgjedhor Partia Socialiste në Bashkinë Elbasan po u bëjnë presion votuesve duke i përcjellë informacion se ditën e votimit, vota e tyre do të jetë lehtësisht e identifikueshme nëpërmjet kryqëzimit të të dhënave midis pajisjes PEI (Pajisja Elektronike e Identifikimit) dhe pajisjes PEVN (Pajisja Elektronike e Votimit dhe Numërimit). Në vijim të këtij presioni, atyre u kërkohet të votojnë për kryetarin aktual të Bashkisë, njëkohësisht kandidat i subjektit zgjedhor PS.

Sipas sinjalizuesve, ky presion po ushtrohet masivisht tek votuesit që kryesisht nuk kanë njohuri të mira mbi teknologjinë dhe përdorimin e saj, duke i kushtëzuar kështu që të besojnë informacionin e përcjellë prej personave përgjegjës dhe se vota e tyre do të zbulohet prej tyre.

KShH vlerëson se nëse këto shqetësime janë të drejta, përbëjnë ushtrim të drejtpërdrejtë presioni ndaj zgjedhësve, ndërkohë që fshehtësia e votës është element substancial i kësaj të drejte që mbrohet në nenin 45, pika 4 të Kushtetutës.

Adresa: Rr. "Brigada e VIII", Pall. TeknoProjekt  
AP.10, Kati 5 Tirana- Albania  
P.O Box/ Kutia Postare No.1752

Tel & Fax: +355 (0) 4 233 671  
e-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)  
Ëeb address: [ëëë.ahc.org.al](http://ëëë.ahc.org.al)



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Duke u bazuar në pikën 6 të Vendimit nr. 004, dt. 13.11.2020 të Komisionit Rregullator i cili parashikon se SEMVR (Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve) duhet të operojë në pajisje dhe në rrjet të dedikuar e të paaksesueshëm, si dhe të mundësojë qendërzimin e të dhënave në mënyrë të sigurt nga të gjitha PEVN dhe në pikën 13 të të njëjtit vendim nëpërmjet të cilit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si dhe, së fundmi, por jo me më pak rëndësi, në parimin kryesor të garantimit të fshehtësisë së votës<sup>1</sup>,

Në situatën e mësipërme, në kushtet kur sinjalizuesit kërkojnë ruajtjen e anonimatit, KShH sugjeron marrjen e masave të karakterit parandalues dhe daljen e KQZ-së me deklarata ndërgjegjësuere publike dhe të shpërndarë gjerësisht në kanalet tuaja zyrtare të komunikimit dhe informimit, si ato tradicionale dhe ato novatore.

Nëpërmjet kësaj deklarate, KShH i sugjeron KQZ-së informimin e qytetarëve me të drejtë vote dhe publikut në tërësi, me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme duke ofruar garancitë e nevojshme të pamundësisë së kryerjes së këtij kryqëzimi të të dhënave midis dy pajisjeve që mundësojnë votimin elektronik e rrjedhimisht, të integritetit të sistemit dhe pamundësisë së cenimit të fshehtësisë së votës nga asnjë palë e tretë.

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!**

Me konsideratë,

**Erida Skëndaj**  
**Drejtoreshë Ekzekutive**  
**Komiteti Shqiptar i Helsinkit**



<sup>1</sup> Kodi Zgjedhor në nenin 3, pika 2 garanton se zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. **Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.**